

URDHËR
Nr. 54, datë 5.2.2013

PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “a” e nenit 6 dhe 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Noteri Vladimir Molla, anëtar i Dhomës së Noterisë Korçë, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 16, datë 17.12.2012, nëpërmjet së cilës kërkon heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit për shkak se e bija e tij znj. Afërdita Molla, është shpallur fituese në provimin e kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë.

Sipas nenit 22 të ligjit nr. 7829/1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, plotësimi i vendit vakant që krijohet për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit, i ofrohet nga Ministri i Drejtësisë bashkëshortes/bashkëshortit ose fëmijëve të tij/saj nëse ata fitojnë mbi 80 për qind të pikëve të konkurrimit ose ushtrojnë profesionin e noterit. Në këtë rast, noteri ka të drejtën të kërkojë t’i dorëzohen regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit që nuk ushtron profesionin e tij.

Me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 518, datë 17.12.2012, znj. Afërdita Molla i është dhënë leja e ushtrimit të profesionit të noterit, pranë bashkisë Korçë.

Bazuar në sa më sipër, lind si e nevojshme heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Vladimir Molla, për shkak të dorëheqjes së tij, si dhe dorëzimi i akteve dhe i regjistrave të tij noterialë, të bijës znj. Afërdita Molla, për shkak të dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit të noterit pranë Dhomës së Noterisë Korçë.

PËR KËTË ARSYE,

Mbështetur në shkronjën “a” të nenit 6 dhe 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Vladimir Molla, anëtar i Dhomës së Noterisë Korçë.

II. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Znj. Odeta Dervishi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

2. Znj. Diana Toro, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

3. Znj. Rezarta Koçi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

4. Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

5. Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Korçë.

III. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Korçë. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45-ditor, noteres Afërdita Molla.

IV. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit Vladimir Molla, nga Komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

V. Të njoftohen menjëherë, institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

VI. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, pranë Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË

Eduard Halimi